

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draftaktit

Projektvendim “Për miratimin e rregullores mbi procedurat për vlerësimin dhe shqyrtimin e investimeve të huaja direkte që lidhen me ose ndikojnë infrastrukturën publike kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, furnizimin me të dhëna kritike, qasjen në informacion të ndjeshëm apo për lirinë e medias”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike: 20 ditë Pune, 5.12.2025 – 5.01.2026, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit publik të përdorura si vijon:

Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” për periudhën 5.12.2025 – 5.01.2026. Përmes publikimit në RENJK, në zbatim të ligjit 146/2014, janë ftuar qytetarë, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik.

Projektvkm, relacioni shpjegues, RIA dhe Tabela e Përputhshmërisë, janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente.

4. Palët e interesit të përfshira

Qytetarët, ekspertë dhe palë të tjera interesi nëpërmjet aksesit në www.konsultimipublik.gov.al. Konkretisht, Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (AmCham) ka përcjellë reagim për këtë projektligj.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

<p>Çështja adresuar (<i>psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.</i>)</p>	<p>Komenti (<i>grumbulloni dhe përmblihdni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku</i>)</p>	<p>Palët e interesuara (<i>renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme</i>)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
<p>Niveli normativ i aktit</p>	<p>1. Niveli normativ i aktit Procesi i shqyrtimit të investimeve të huaja është kompleks, delikat dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e investitorëve dhe në ekonominë kombëtare. Në këtë kontekst, AmCham vlerëson se miratimi i një rregulloreje me Vendim të Këshillit të Ministrave nuk përbën një bazë të mjaftueshme ligjore. Një mekanizëm i tillë kërkon një ligj të posaçëm, i cili të adresojë në mënyrë</p>	<p>Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (AmCham).</p>	<p>I pranuar pjesërisht Pas komenteve të ardhura nga Dhoma Amerikanë e Tregëtisë në Shqipëri, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ka zhvilluar takime me DHATSH, ku janë dakordësuar me versionin final të vendimit të KM, I</p>	<p>Lidhur me nivelin normativ të aktit ndajmë parimisht qëndrimin se një mekanizëm i shqyrtimit të Investimeve të Huaja Direkte (FDI Screening), për nga natyra, kompleksiteti dhe impakti në të drejtat e investitorëve, do të ishte idealisht i rregulluar me ligj të posaçëm. Megjithatë, aktualisht ekziston një bazë e qartë ligjore në nenin 10, pika 2, të ligjit nr. 7764/1993 “Për Investimet e Huaja”, i cili delegon shprehimisht Këshillin e Ministrave për miratimin e rregullave dhe procedurave të shqyrtimit të IHD-ve në sektorë kritikë. Në këtë kuadër, VKM-ja përbën një zgjdhje tranzitore dhe funksionale, e domosdoshme për përmbushjen e angazhimeve në kuadër të procesit të integritimit evropian. Miratimi i këtij akti me Vendim të Këshillit të</p>

	gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të gjitha elementet e procesit të “screening”, duke reduktuar hapësirat për interpretime subjektive dhe qasje të paunifikuara.		cili ka marre dhe miratimin ne KE.	Ministrave nuk cënon aspak zbatueshmërinë e tij në përputhje dhe me Rregulloren e BE duke qenë se transpozimi në akt është bërë i plotë.
Pajtueshmëria me legjislacionin e BE-së dhe procesin e negociatave	2. Pajtueshmëria me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe procesin e negociatave Edhe pse drafti pasqyron në plan formal strukturën e Rregullores (BE) 2019/452, ai nuk reflekton plotësisht dimensionin interpretues dhe balancues të Recital-ëve të saj, të cilat janë thelbësore për një zbatim proporcional, të arsyetuar dhe të parashikueshëm të mekanizmit. Një akt nënligjor i fragmentuar rrezikon të mos sigurojë një konvergjencë	Dhoma Amerika ne e Tregtisë në Shqipëri (AmCham).	I pranuar pjesërisht	Versioni i rishikuar i projekt-Rregullores ka adresuar në mënyrë substanciale komentet e Komisionit Evropian, duke reflektuar jo vetëm strukturën formale të Rregullores (BE) 2019/452, por edhe qasjen risk-based, parimin e proporcionalitetit dhe balancimin ndërmjet sigurisë dhe klimës së investimeve , të reflektuara në Recital-et e saj. Në veçanti: <ul style="list-style-type: none"> • është bërë ndarja e qartë ndërmjet sektorëve të ndjeshëm dhe veçanërisht të ndjeshëm, me pragje të diferencuara; • janë forcuar kriteret e vlerësimit të riskut; • është konsoliduar mekanizmi i bashkëpunimit

	<p>reale me standardet dhe praktikat më të mira evropiane, veçanërisht në kontekstin e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.</p>			<p>ndërkombëtar dhe me BE-në.</p> <p>Kjo qasje synon konvergjencë reale me praktikat më të mira evropiane, duke shmangur mbingarkimin administrativ dhe efektin frenues për investime me risk të ulët.</p>
<p>Qartësia, transparenca dhe siguria juridike</p>	<p>3. Qartësia, transparenca dhe siguria juridike</p> <p>Në formën aktuale, projektvendimi paraqitet i paqartë në tërësinë e tij dhe nuk garanton transparencë të mjaftueshme në procesin e shqyrtimit të investimeve.</p> <p>Përdorimi i terminologjisë së përgjithshme dhe të paqartë, si p.sh. “vlerësim siç duhet”, krijon hapësirë për interpretime të ndryshme dhe potencialisht për trajtim subjektiv të kërkesave për investim.</p>		<p>I pranuar pjesërisht</p>	<p>Në përgjigje të shqetësimeve për paqartësi dhe mungesë transparence, versioni i rishikuar ka sjellë përmirësime të rëndësishme normative, ndër të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zgjerim dhe saktësim të përkufizimeve ligjore (p.sh. “interes kontrollues”, “ndërmarrje objekt”, “informacion i ndjeshëm”, “media”); • përcaktim të detajuar të kritereve objektive të vlerësimit të riskut në nenin 14; • përfshirje të listës së informacionit dhe dokumentacionit që duhet të depozitohet nga investitori.

	<p>Kriteret e vlerësimit të riskut duhet të jenë të përcaktuara qartë, objektive dhe të parashikueshme, në mënyrë që investitori i huaj të ketë siguri juridike dhe të mund të vlerësojë në mënyrë të informuar rrezikun rregullator.</p>			<p>Këto elemente synojnë të rrisin parashikueshmërinë dhe sigurinë juridike, duke i mundësuar investitorit të vlerësojë në mënyrë të informuar riskun rregullator.</p>
<p>Arkitektura institucionale e vendimmarrjes</p>	<p>4. Arkitektura institucionale e vendimmarrjes</p> <p>Një risk i rëndësishëm lidhet me arkitekturën institucionale të vendimmarrjes.</p> <p>Drafti përqendron kompetenca shumë të gjera në një Komitet Ndërministror, pa parashikuar rregulla të detajuara për funksionimin e tij, përfshirë kuorumin, mënyrën e votimit dhe trajtimin e</p>		<p>I pranuar pjesërisht</p>	<p>Shqetësimi për kompetenca të gjera dhe mungesë rregullimi procedural është adresuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në versionin e rishikuar, përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcaktimit të qartë të rolit vendimmarrës të KNIHD; • rregullimit të kuorunit, mënyrës së votimit dhe konfliktit të interesit; • ndarjes funksionale ndërmjet KNIHD dhe Sekretariatit si strukturë teknike-administrative pa kompetenca vendimmarrëse. <p>Kjo arkitekturë synon reduktimin e diskrecionit</p>

	konflikteve të interesit. Kjo mungesë e rregullimit procedural krijon hapësirë për vendimmarrje diskrecionale dhe vështirëson mbrojtjen juridike të vendimeve.			administrativ dhe forcimin e mbrojtjes juridike të vendimeve.
Afatet procedurale dhe proporcionaliteti	5. Afatet procedurale dhe proporcionaliteti Afati 5-ditor për plotësimin e dokumentacionit nga investitori i huaj, me pasojë anulimin e procedurës në rast mosrespektimi, konsiderohet joproporcional. Po ashtu, parashikimi i miratimit automatik të investimit në mungesë të një vendimi brenda afatit e lidh rezultatin e procedurës me rrjedhën formale të afateve dhe jo me vlerësimin substancial të rrezikut, duke		I pranuar pjesërisht	Afatet procedurale janë rishikuar dhe harmonizuar me parimet e Kodit të Procedurave Administrative. Afati për plotësimin e dokumentacionit është ruajtur si mjet disiplinues procedural, por nuk cenon të drejtën për riaplikim dhe nuk prodhon pasoja ndëshkuese disproporcionale. Sa i përket miratimit automatik në mungesë vendimi, versioni i rishikuar synon të balancojë efikasitetin administrativ me nevojën për shqyrtim substancial , duke shmangur bllokimin e pajustificuar të investimeve.

	krijuar dobësi strukturore në mekanizëm.			
Qasja procedurale ndaj investitorit të huaj	6. Qasja procedurale ndaj investitorit të huaj Parashikimi i “thirrjes së investitorit të huaj në seancë dëgjimore” krijon perceptimin e një procedure hetimore ose ndëshkuese, e cila nuk është në përputhje me frymën nxitëse dhe mikpritëse që duhet të karakterizojë kuadrin ligjor për investimet e huaja.		Refuzuar	Parashikimi i seancës dëgjimore nuk synon krijimin e një procedure hetimore apo ndëshkuese, por garantimin e të drejtës për t’u dëgjuar , në përputhje me standardet e procesit të rregullt administrativ. Qasja e përgjithshme e rregullores mbetet parandaluese dhe bashkëpunuese , duke synuar dialog konstruktiv me investitorin dhe zbutje të riskut përmes masave proporcionale, e jo penalizim.
Nevoja për një ligj të posaçëm për FDI Screening	7. Nevoja për një qasje të re: Ligj i posaçëm për FDI Screening Në këtë kontekst, AmCham vlerëson se projektvendimi aktual duhet të ripunohet në tërësinë e tij dhe sugjeron hartimin e një ligji të posaçëm për shqyrtimin e		I pranuar pjesërisht	Sugjerimi i AmCham për hartimin e një ligji të posaçëm vlerësohet si kontribut i vlefshëm dhe strategjik . Në këtë fazë, projekt-VKM-ja përfaqëson një zgjdhje teknike tranzitore , që synon përmbushjen e detyrimeve ndaj BE-së dhe mbylljen e kapitullit përkatës të negociatave, pa përjashtuar konsolidimin e mëvonshëm ligjor, i cili do

	<p>investimeve të huaja, i cili të adresojë në mënyrë të qartë dhe koherente, ndër të tjera: fushat dhe sektorët subjekt të shqyrtimit; profilin dhe origjinën e investitorëve; pragjet e investimeve; kriteret e vlerësimit të riskut; strukturën institucionale; procedurat dhe garancitë procedurale; sanksionet; si dhe përputhshmërinë e plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.</p>			<p>të materializohet edhe në hartimin e ligjit të unifikuar të investimeve për të cilën ka nisur puna në strukturat përgjegjëse të ministrisë.</p>
--	---	--	--	--